



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2019

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 49, pika 6, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas përcaktimit “nga media audiovizive” shtohet përcaktimi “dhe nga ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT

GRAMOZ RUÇI

11.2.19
to flet me
propozim per te
propozim per te
propozim per te



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

Lënda: Depozitimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e subjektit kushtetues, për të ndërmarrë nismë legislative, propozoj projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Përmes këtij projektligji, propozohet që shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 %, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike.

Ky propozim do të mundësojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues midis ofruesve të shërbimeve audiovizive dhe elektronike.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë, depozitohet projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shoqëruar nga relacioni shpjegues.

DEPUTETI PROPOZUES

Arben AHMETAJ